

VENDIM
Nr.204, datë 16.4.2004

**PËR MASËN DHE KRITERET PËR PËRFITIM PAAFTËSIE NGA PERSONAT ME
STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Invalidët e punës, të cilët kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet, në institucionet shtetërore, ish-kooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale a janë aksidentuar në punë apo kanë sëmundje të ndryshme, e që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ose të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", të ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, nga fondi i pagesës së personave me aftësi të kufizuar, si më poshtë vijon:

- a) Personat që përfitojnë pension invaliditeti të plotë 3 000 lekë
- b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm 2 000 lekë

2. Invalidët, të cilët përfitojnë sipas shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 2 të vendimit nr.381, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore të barabartë me diferencën ndërmjet masës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi si përfitim paaftësie dhe të përfitimit të përcaktuar në vendimin nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave.

3. Kjo shtesë u jepet invalidëve të punës pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale dhe nuk llogaritet në të ardhurat e familjes. Ajo përfitohet edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqërie.

4. Organet e sigurimeve shoqërore dërgojnë zyrtarisht kopje të vërtetimeve të KMCAP-it për paaftësinë në punë, listën e përfituesve dhe masën e përfitimit, sipas vendimit nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, pranë zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Këto zyra përgatisin listën e përfituesve dhe urdhërpagesën, të cilat i dërgojnë në zyrat e njësive të pushtetit vendor ku invalidët kanë vendbanimin.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgatit vërtetimin tip të KMCAP-it për paaftësinë në punë, të parashikuar në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Pagesa tërhiqet nga invalidi çdo muaj pranë zyrave të njësive të pushtetit vendor, duke paraqitur dokumentin e identifikimit.

7. Ngarkohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shkurt 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano